



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 11.06.2019)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:42 dhe mbaroi në orën 14:58.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zonja Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
5. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
6. *Edlira Bako, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Armand Sokoli, Komiteti Shqiptar i Helsinkit.*
8. *Gregor Borgoëski, EURALIUS.*
9. *Klodian Rado, EURALIUS.*
10. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
11. *Erion Fejzulla, USAID.*
12. *Marjana Papa, OSBE.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit””.

Maksim Qoku: Përshëndetje, të nderuar anëtarë!

Përshëndetje, të ftuar!

Vijomë në mbledhjen e radhës.

Natyrisht që sot në këtë mbledhje mungon Kryetarja e institucionit, zonja Llagami, për shkak të angazhimeve të saj në funksion të detyrës jashtë shtetit. Kështu që në bazë të nenit 60, të ligjit 115/2016 për qeverisjen, këtë mbledhje do ta drejtoj në cilësinë e Zëvendëskryetarit.

Gjithashtu, për efekt të kuorumit, nenit 68 të po këtij ligji, mendoj që përveç mungesës së saj, nuk ka mungesa të tjera, kështu që kuorumi është i mjaftueshëm për ta zhvilluar këtë mbledhje.

Sot në fakt, kemi vetëm 1 pikë për rendin e ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit””. Natyrisht që është punuar për shumë kohë në lidhje me këtë lloj ndryshimi. Duke qenë paksa edhe në efektin e urgjencës për disa transferime të cilëve u mbaron afati shpejt dhe unë thashë që ta fusnim të vetme në rendin e ditës.

Për më tepër, me relacionin dhe me ndryshimet është marrë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ndaj po i lë fjalën për relatimin, kryetarit të këtij Komisioni, zotit Toska. Fjala për ju, zoti Toska!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ju ka paraqitur një propozim për shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”. Ky propozim nga ana e Komisionit është bërë si rezultat i nevojës që ka dalë gjatë zbatimit në praktikë të rregullores së miratuar më herët në Këshillin e Lartë Gjyqësor, qoftë në dy procedurat e transferimit që Këshilli ka shpallur por që janë ndërprerë për shkak të problematikave që kanë rezultuar, po kështu edhe nevoja ka rezultuar edhe për shkak se jemi në ditët e fundit kur përfundon transferimi i përkohshëm me pëlqim i disa gjyqtarëve, të cilët janë transferuar përpara 1 viti nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me pëlqimin e tyre, në disa gjykata të vendit.

Si rezultat i problematikave të hasura gjatë zbatimit, por duke konsideruar edhe situatën më së fundmi në lidhje me gjykatat ku tashmë ka të transferuar gjyqtarë me pëlqim nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, këto problematika kemi munduar t'i reflektojmë në ndryshimet që duhet të pësojë rregullorja, qoftë sa i përket procedurave, qoftë sa i përket transferimit me pëlqim për përmirësimin e rregullores, për ta bërë atë sa më të zbatueshme si edhe për të konsideruar standardet e pranuar ndërkombëtarisht.

Për të bërë këto propozime kemi marrë edhe opinionet nga dy misionet që asistojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor, nga ekspertë të EURALIUS-it dhe USAID-it. I janë bashkëlidhur materialeve të mbledhjes opinionet më lart.

Kemi konsideruar që duhet të ndërhyhet veçanërisht sa i përket termave të transferimit me pëlqim por edhe ndonjë modifikim i vogël në lidhje me transferimin pa pëlqim. Më konkretisht keni një draft të konsoliduar bashkë me shtesat dhe ndryshimet që ne kemi propozuar, për t'u kuptuar qartë e gjithë procedura dhe logjika që ne kemi ndjekur. Ndërkohë që keni enkas edhe një projektvendim për çdo shtesë apo ndryshim që ne kemi propozuar.

Mund të them që propozimet konsistojnë me identifikimin sa më të qartë të gjyqtarit me përvojën më të pakët në atë gjykatë, kjo është e domosdoshme në raport me transferimin pa pëlqim, për të cilin kemi pasur një problematikë gjatë zbatimi të saj në dy raste. Ndërkohë, kemi konsideruar që kishte vend për përmirësimin e rregullores sa i përket inicimit të procedurës së transferimit. Nga rregullat e mëparshme duket sikur Këshilli mblidhej vetvetiu dhe shpallte hapjen e procedurës për transferim të përkohshëm. Kemi modifikuar/përmirësuar rregulloren në këtë pikë, ku është Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ai që duhet të identifikojë, qoftë me kërkesë të gjykatës apo edhe kryesisht, një nevojë të caktuar në një gjykatë konkrete që mund të plotësohet nevoja vetëm përmes transferimit të përkohshëm. Kemi përmirësuar situatën në lidhje me gjykatat ku ka të transferuar përkohësisht, që nuk është pasur në vëmendje më herët. Kemi përmirësuar sa i përket transferimit pa pëlqim duke konsideruar disa përmirësime në procedurën për ndjekjen e transferimit të përkohshëm pa pëlqim, duke konsideruar gjithmonë që Këshilli duhet të jetë vendimmarrës për çdo hap të procedurave që ndihen, jo thjesht kjo procedurë të mbetet siç më herët lihej të kuptohej vetëm për Komisionin e Zhvillimit të Karrierës dhe vendimi final të ishte i Këshillit. Kemi konsideruar që Këshilli mund të ndërhyjë në të gjitha etapat e kësaj procedure.

Më konkretisht, kemi propozuar që në nenin 3 të bëhet shtesë në pikën 2, të shtohet një shkronjë “ë” me përmbajtjen si më poshtë: “ë) “Gjyqtari me përvojën më të pakët në atë gjykatë” nënkupton gjyqtarin e gjykatës nga ku do të bëhet transferimi, i cili ka përvojën më të pakët si gjyqtar në të njëjtën shkallë gjykimi”.

Në ligj formulimi është pak evaziv, duket sikur gjyqtari në atë gjykatë që ka përvojë në atë gjykatë, në fakt qëllimi i ligjvënësit nuk është thjeshtë nevoja në atë gjykatë. Kemi konsideruar që është përvoja të paktën në atë nivel gjykate.

Në nenin 4 kemi propozuar të bëhet ndryshim në titullin e kësaj dispozite, ku pas fjalës “Parimet” të shtohen “dhe kriteret”, pasi në realitet, kjo dispozitë përmban përveç parimeve edhe disa kriteret të transferimit të përkohshëm.

Konkretisht, në nenin 4, përveç këtij ndryshimi, në pikën 4, pas fjalës “transferim i përkohshëm”, propozojmë të shtohet fjala “si rregull”, ndërsa po në këtë pikë, pas fjalisë së parë, të shtohet fjalia “Përrjashtimisht, nëse transferimi i përkohshëm sipas këtij rregulli do të cenonte funksionalitetin e gjykatave me ngarkesë më të ulët, transferimi mund të bëhet nga gjyqtarët e gjykatave të tjera, por në çdo rast duke respektuar parimin sipas pikës 3 të këtij neni”, që bën fjalë për ndikimin e transferimit, pra në efektet negative apo pozitive që mund të sjellë transferimi në gjykatën nga dhe ku bëhet transferimi i gjyqtarit.

Po kështu, kemi propozuar që në këtë dispozitë, pra në nenin 4, në fund të pikës 6 të shtohet edhe fjalia “Pavarësisht kësaj, me pëlqimin e gjyqtarit, transferimi i përkohshëm mund të përsëritet, sipas procedurës së përcaktuar në Kreun II të kësaj rregulloreje”. Kemi konsideruar që transferimi i përkohshëm me pëlqim, përjashtimisht mund të përsëritet, ndryshe nga transferimi i përkohshëm pa pëlqim, për sa kohë kjo lëvizje është edhe me pëlqimin e gjyqtarit dhe ligji nuk kufizon përsëritjen e transferimit, kuptohet që kontrolli periodik i Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të jetë jo më vonë se 1 vit, pra brenda çdo 1 viti, Këshilli duhet të konsiderojë transferimin e përkohshëm të një gjyqtari me pëlqim.

Në pikën 8, të nenit 4, kemi propozuar që pas fjalëve “periudhës së transferimit”, të shtohet fjala “të përkohshëm”, për të qenë e qartë që bëhet fjalë për transferimin e përkohshëm.

Më tej, në nenin 5 propozuar të bëhen këto shtesa dhe ndryshime: Pika 1 të riformulohet me përmbajtjen si më poshtë: “Kur një gjykatë është në nevojë dhe në skemën e delegimit nuk ka gjyqtar/ë të disponueshëm, me kërkesë të gjykatës në nevojë ose kryesisht, kur vlerëson se nevoja e gjykatës ekziston dhe plotësimi i saj mund të bëhet vetëm përmes transferimit të përkohshëm, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm që është i hapur për transferim dhe u bën thirrje gjyqtarëve për të dhënë pëlqimin”. Në këtë dispozitë, kemi edhe një procedurë mbi të cilën Këshilli inicion shpalljen e procedurës së transferimit të

përkohshëm, sikundër edhe organin, pra Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili është ai që duhet të vlerësojë që në një situatë të caktuar në një gjykatë konkrete, do duhet të bëhet transferimi i përkohshëm për të plotësuar nevojat e asaj gjykate.

Po kështu në nenin 5, pas pikës 1 kemi propozuar të shtohen 2 pika: Pika 1.1 me këtë përmbajtje: “1.1 Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave. Thirrja përmban kriteret e transferimit të përkohshëm sipas rastit në fjalë dhe modelin e dhënies së pëlqimit sipas modelit bashkëlidhur kësaj rregulloreje”. Ky formulim ka qenë edhe më herët. Ka qenë në nenin 6. Kemi menduar që do të ishte më e drejtë që ky parashikim, ky rregull të ishte brenda përmbajtjes së nenit 5 të rregullores.

Po kështu kemi propozuar që të shtohet edhe pika 1.2 në nenin 5, me këtë përmbajtje: “1.2 Nëse nevoja në gjykatën në të cilën ka të transferuar përkohësisht me pëlqim një gjyqtar, mund të përmbushet sërish vetëm përmes transferimit të përkohshëm, Këshilli shpall pozicionin e lirë të përkohshëm duke ftuar, fillimisht, për të dhënë pëlqimin, gjyqtarin që është i transferuar në atë gjykatë, nëse transferimi i tij nuk cenon funksionalitetin e gjykatës ku ai është caktuar në mënyrë të përhershme. Në një rast të tillë, ky gjyqtar mund të transferohet përsëri përkohësisht në gjykatën në nevojë në rast se jep pëlqimin”. Nëpërmjet kësaj dispozite, kemi konsideruar që të përmirësohet rregullorja, kjo sa i përket rrethanave kur në një gjykatë në nevojë ka të transferuar përkohësisht gjyqtarë dhe transferimi i tyre përfundon, se çfarë duhet të ndodhë mbas këtij transferimi.

Po kështu, në nenin 5 kemi propozuar që në pikën 4 (*lapsus, pasi është pika 3*), pas fjalëve “për trajtimin e kërkesës për transferim”, të zëvendësohet me fjalët “të procedurës së transferimit të përkohshëm”. Kjo për të qartësuar se çfarë duhet të bëjë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ndërsa shprehja e përdorur më herët nuk ishte shumë e qartë në këtë drejtim.

Më tej, në nenin 6 kemi propozuar të ndryshohet përmbajtja e tij tërësisht dhe ky nen të ketë këtë përmbajtje: “1. Në rastin e shpalljes së një pozicioni të lirë të përkohshëm në një gjykatë, në të cilën ka gjyqtarë të transferuar përkohësisht me pëlqim, dhënia e pëlqimit i kërkohet fillimisht këtij gjyqtari. 2. Nëse gjyqtari i transferuar

përkohësisht me pëlqim në një gjykatë që është sërish në nevojë, nuk jep pëlqim, si dhe në çdo rast tjetër të shpalljes së një pozicioni të lirë në një gjykatë në nevojë, dhënia e pëlqimit iu kërkohet të gjithë gjyqtarëve që përmbushin kriteret për pozicionin e lirë të përkohshëm të shpallur. 3. Thirrja për aplikim publikohet në faqen e internetit të Këshillit dhe u komunikohet gjyqtarëve nëpërmjet kryetarëve të gjykatave. Thirrja përmban edhe kriteret e transferimit të përkohshëm”. Në këtë rast kemi konsideruar që për transferimin me pëlqim duhet të ketë dy shpallje, më saktë shpallja duhet që t’i drejtohet dy rretheve të gjyqtarëve, fillimisht gjyqtarëve që janë të transferuar, nëse gjykata në nevojë ka gjyqtarë të transferuar, dhe në rastin tjetër kur gjyqtari në një gjykatë të tillë nuk jep pëlqimin apo në çdo rrethanë tjetër kur gjykata nuk ka gjyqtarë të transferuar, shpallja të bëhet për të gjithë gjyqtarët e republikës që mund të japin pëlqimin.

Më tej, në nenin 7 kemi propozuar të bëhen këto ndryshime: Në pikën 2 fjalët “të përcaktuara në kërkesë” duhet të hiqen, pasi del e pakuptimtë fjalia dhe duke hequr atë bëhet më i qartë rregulli i parashikuar në këtë pikë.

Në nenin 8 kemi propozuar të bëhen këto shtesa: Në pikën 1, pas fjalëve “plotësimi të kriterëve”, të shtohet fjala “të transferimit”, që të kuptohet qartësisht se për çfarë kriteri bëhet fjalë. Në pikën 3 pas fjalëve “për transferim të përkohshëm”, të shtohet fjalia “bazuar në ndikimin e transferimit, në ngarkesën e gjyqtarit që ka dhënë pëlqimin, si dhe në përvojën profesionale të tij në raport me fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi”. Kjo për të përcaktuar qartë se ku duhet të bazohet Komisioni por edhe Këshilli në lidhje me vlerësimin e kriterëve për transferimin e përkohshëm të një gjyqtari të caktuar.

Në nenin 10 kemi propozuar të bëhen këto shtesa dhe ndryshime: Në pikën 1 fjalët “dhe nis procedurat e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari pa pëlqim”, kemi propozuar të zëvendësohen me fjalët “i cili vendos për nisjen e procedurës së transferimit të përkohshëm pa pëlqim të një gjyqtari”. Pra është Këshilli ai që është vendimmarrës, që duhet të vendosë nëse është i pamundur transferimi pa pëlqim, të fillohen procedurat e transferimit pa pëlqim.

Më tej, në nenin 11 kemi propozuar të bëhen këto shtesa dhe ndryshime, në pikën 1, shkronja /c/, të hiqen fjalët “në atë gjykatë”. Kjo për të përcaktuar... kjo sa i përket përkufizimit të gjyqtarit me përvojën më të pakët në atë gjykatë që bën fjalë ligji.

Së fundi, në nenin 12 kemi propozuar të bëhen këto ndryshime: Në pikën 1 fjalët “shqyrton informacionin e mbledhur sipas nenit 6”, sa kohë rikonsideruam të gjithë procedurën, kemi propozuar që të zëvendësohen me fjalët “kërkon nga kryetarët e gjykatave informacionin e nevojshëm”, i cili është i nevojshëm për të përcaktuar gjykatën me ngarkesën më të ulët, nga e cila do duhet më pas të caktohet për transferim pa pëlqim një gjyqtar i saj.

Ndërkohë, kemi propozuar të riformulohet pika 2 me përmbajtjen si më poshtë: “2. Pas përcaktimit të gjykatës me ngarkesën më të ulët, duke mbajtur në konsideratë edhe kërkesat e pikës 4, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon në atë gjykatë gjyqtarin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t’u transferuar përkohësisht. Në rastin e disa gjykatave me ngarkesë më të ulët sipas kësaj pike, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës identifikon për secilën nga këto gjykata gjyqtarin me përvojën më të pakët, i cili përmbush njëkohësisht edhe kriteret për pozicionin që kërkohet për t’u transferuar përkohësisht”. Në këtë rast kemi konsideruar se çfarë duhet të bëjë Komisioni në procedurën e transferimit pa pëlqim, sikundër kemi konsideruar edhe një situatë hipotetike nëse janë më tepër se një gjykatë me ngarkesë më të ulët, ku në secilin rast Komisioni duhet t’i propozojë Këshillit gjyqtarin me ngarkesën dhe me përvojën më të pakët, i cili mund të transferohet përkohësisht pa pëlqim nga Këshilli. Është në diskrecionin e Këshillit të vlerësojë pastaj se kush nga disa gjyqtarët duhet të jetë ai që duhet të transferohet përkohësisht pa pëlqim. Këto ishin të gjitha propozimet e bëra nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ne paraprakisht kemi diskutuar edhe me shumicën e anëtarëve në lidhje me këto përmirësime. Gjithsesi, jemi të hapur për çdo pyetje apo çdo sqarim që mund të bëhet për çdo element të përmirësuar të rregullores për transferim të përkohshëm të gjyqtarëve.

Maksim Qoku: Faleminderit, zoti Toska!

Më lejoni t'ju falenderoj për punën tuaj të palodhur por edhe të kujdesshme, ju dhe anëtarët e tjerë të Komisionit. E lë fjalën për anëtarët nëse duan të shprehin opinionet e tyre në përgjithësi për ndryshimet apo edhe në pjesë të veçanta të tij.

Natyrisht unë e thashë që ne kemi qenë pjesë e konsultimeve, sidomos dy komisionet, pa i humbur meritat, etika dhe karriera kanë qenë aktiv. Por vetëm të orientohemi, do ta kalojmë nën për nën apo do ta kalojmë aktin në bllok, duke përfshirë të gjithë ndryshimet, meqë kolegu i parashtrori dhe pak a shumë ne jemi në dijeni.

Atëherë, nëse jeni dakord për ta kaluar në bllok, le të kalojmë në procesin e votimit.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Maksim Qoku: Dakord.

Atëherë, miratohet akti i mësipërm në lidhje me ndryshimet mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit. Administrata do merret me dërgimin e akteve për botim në fletoren zyrtare. Mirë është në kohën sa më shpejt të mundshme, që të procedojmë pastaj me procedurat në vijim.

Nëse s'kemi gjë tjetër, ju falenderoj!

Ilir Toska: Atëherë, administrata duhet të konsiderojë, mbas publikimit në fletoren zyrtare, që të publikojë në faqen tonë versionin e konsoliduar të rregullores për transferimin e përkohshëm. Është detyrim ligjor që duhet ta mbajë parasysh. Faleminderit!

Maksim Qoku: Okej atëherë, faleminderit!

Me sqarimin që u bë, administrata besoj e mori mesazhin, kështu që, po s'kemi gjë tjetër, ju falënderoj për pjesëmarrjen! Takohemi në mbledhjet e ardhshme!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor